

VENDIM
Nr. 461, datë 22.6.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR
PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republi-kën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prej 5 100 000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekësh, për ngritjen e sistemit elektronik për administrimin e kërkesave për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama